

Enkeled Fizmani



UNIVERSITETI
ALEKSANDER MOISIU, DURRËS

Fakulteti i Shkencave Politike Juridike
Departamenti Administrim Publik
Master Shkencor
Administrim Publik

TEME DIPLOME

Financimi i Partive Politike
Financing of Political Parties

PUNOI:
Enkeled Fizmani

UDHËHEQËS:
Dr. Elena Kocaqi

1 Tetor 2016


LIBRARI
L A M B
N. 6981

Përmbajtja e Lëndës

I.	Abstrakti.....	6
II.	Parathenie.....	7
III.	Metodologjia.....	8
KREU I : Partite Politike dhe Funkcionet e Tyre		
1.1.	Çfarë është një parti politike?.....	10
1.2.	Funksionet e partive politike.....	14
1.3.	Financimi i Partive Politike dhe Kandidate	
	<i>a. Argumentet kundër financimit të partive politike dhe fushatave nga buxheti i shtetit:</i>	<i>14</i>
	<i>b. Argumente pro financimit publik të partive politike dhe kandidatëve:.....</i>	<i>15</i>
	<i>c. Limitet mbi financimet private.....</i>	<i>16</i>
	<i>d. Ndihmat publike.....</i>	<i>17</i>
1.4.	Politika dhe paraja.....	18
1.5.	Kontrolli shtetëror i financimit të partive politike.....	20
1.6.	Financimi i fushatave zgjedhore.....	23
1.7.	Mbledhja e fondeve për partië.....	27
1.8.	Buxheti i Partisë.....	30
KREU II : Kontrolli Ligjor dhe Institucional për Financimin e Partive Politike		
2.1.	Transparenca e të ardhurave të partive politike.....	34
2.2.	Sanksionet ndaj partive politike për shfrytëzimin e pasurive publike.....	40
2.3.	Problemet e Financimit të Partive Politike në Shqipëri.....	42
	Përfundime.....	48
	Bibliografia.....	51

Enkeled Fizmani

DEKLARATË



Unë, i nënshkruari Enkeled Fizmani deklaroj që:

(1) Kjo mikrotezë përfaqëson punimin tim origjinal, përveç rasteve të citimeve dhe referencave dhe

(2) Kjo mikrotezë nuk është përdorur më parë si mikrotezë apo projekt kursi në këtë Universitet apo në Universitete të tjera.

Tetur 2016

Mirënjohje!

Për të realizuar këtë temë nuk ka qenë e lehtë për mua, ndaj ndihma e njerëzve që më rrethojnë ka qenë e domosdoshme.

Për këtë arsye, gjej rastin të falënderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen time në radhë të parë udhëheqëses shkencore **Dr. Elena Kocaqi** për udhëzimet, ndjekjen dhe mbështetjen e saj të vazhdueshme.

Falënderime për gadishmërinë e saj për t'më ndihmuar, mësuar dhe sqaruar në lidhje me çdo detaj që mund të më çonte në përfundime të rëndësishme.

Në të njëjtën kohë dua të falënderoj në mënyrë të veçantë familjen time të shtrenjte , miqtë dhe kolegët e mi që më ndihmuan në realizimin e studimit, pa mbështetjen e të cilëve ky punim nuk do të mund të realizohej.

“Padyshim se të gjitha mendimet e njeriut dhe i tërë veprimi i njeriut shpeshherë varet nga koha dhe u nënshtrohen ndryshimeve. Por, nëse formojmë parti politike, e cila u përmbahet kërkesave të cilat i dikton koha, atëherë partia e fillë do të jetë sterile dhe jetëshkurtër. Veçanërisht partitë ose, thënë më mirë, sidomos partitë politike në qoftë se dëshirojnë të mbijetojnë, duhet të ndërtohen në thellësi. Ato duhet të bazohen në vlera të përjetshme.”

Konrad Adenauer

Abstrakti

Ky punim ka si qellim qe te trajtoj financimin e partive politike ne Shqipëri. Ai synon të trajtoj konceptin e partisë dhe funksionet qe kryen një parti politike. Studimi synon tu përgjigjet pyetjeve si financohen partitë politike? A ka transparencë për fondet publike dhe private te financimit? A kontrollohen fondet e partive politike? Cila është problematika e financimit te partive politike ne Shqipëri? Këto janë disa prej pyetje qe do te marrin përgjigje ne këtë punim. Studimi bazohet ne analizën e literaturës dhe ligjeve për financimin e partive politike.

Key words; financimi i partive politike, transparencë, kontrolli.

Abstract

This paper aims to treat the financing of political parties in Albania. It aims to treat the concept of party and functions of the political party. The study aims to answer the question; how political parties are funded? Is there transparency for public and private funds of financing? Are the funds of political party controlled? What is the problematic of financing of the political parties in Albania? These are some of the questions that will take answer in this paper. The study is based on analysis of literature and law on the financing of political parties.

Key words; financing of political parties, transparency, control.

PARATHENIE

Qëllimi i studimit

Studimi synon të trajtoj financimin e partive politike në Shqipëri

Objektivat e studimit

Te përcaktoj funksionet e partive politike

Te përcaktoj mënyrat e financimit të partive politike

Te sqaroj transparencën në lidhje me fondet dhe rendësin e tyre

Te përcaktoj kontrollin e financimit të partive politike

Hipoteza

Nëse do të kishte më tepër transparencë në financimin e partive politike, do reduktohej financimi i paligjshëm i partive politike.

Metodologjia

Ky punim diplome trajton një nga temat me shumë interes sic është financimi i partive politike sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Shpesh dëgjohet që financat e partive janë një nga pikat më të rrehta në një fushatë zgjedhore, sepse fondet e padeklaruara mund të jenë gjithmonë një çështje e cila vlen të diskutohet. Për këtë arsye është theksuar dhe ideja e transparencës së të ardhurave në një parti politike, duke e vlerësuar si një domosdoshmëri për të ardhmen e politikës në vendin tonë.

Mbarëvajtja e veprimtarisë politike, në kuadër të financimit të partive politike shqiptare, e cila mbetet një indikator me rëndësi kombëtare për forcimin e demokracisë, shtetit ligjor, dekriminalizimit të politikës dhe kausivitetit ndaj praktikave politike të kundraligjshme në Shqipëri. Në zgjedhjet politike të vitit 2013 dhe zgjedhjet administrative të vitit 2015, partitë politike në Shqipëri vijuan të denoncohen në raportet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare për probleme lidhur me transparencën e financimit dhe sponsorizimit të veprimtarisë së tyre. Po ashtu me gjithë ndryshimet ligjore në vitin 2011 dhe 2014 në ligjin për Partitë Politike, vërehet se nuk ka një zgjidhje të përhershme të të gjitha problemeve të financimit dhe transparencës në këtë fushë, çka ngre shumë dyshime për një garë të pandershme politike dhe për konsumimin e praktikave të parregullta ose me natyrë kriminale të tyre. Në mars 2016 Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert mori iniciativën e realizimit të databasë mbi partitë politike, zgjedhjet dhe institucionet politike në Shqipëri. Ky projekt përbën rastin e parë të publikimit të dokumenteve kryesore të partive politike prej vitit 1990. Database mbetet një arkiv dedikuar partive politike, medias, studentëve të shkencave politike, OJF-ve që veprojnë në këtë fushë, si dhe grupimeve e individëve të tjerë të interesuar mbi problematikat e organizimit dhe funksionimit të partive politike. Në kuadër të këtij projekti, krahas publikimit të dokumenteve themelore të partive politike, statuteve dhe programeve, zgjedhjeve dhe zhvillimeve të brendshme, një vend të veçantë zënë praktikat e financimit dhe problematikat e hasura në jetën politike të vendit. Database është munduar të reflektojë krahas të tjerash edhe praktikat më të mira të

Enkeled Fizmani

financimit të partive politike në vendet rajonale dhe evropiane, studimet profesionale mbi legjislacionin shqiptar dhe evropian mbi partitë politike, zgjedhjet, si dhe aspekte të veçanta të studimit të raportit dhe aktivitetit të partive politike.

- **Materialet për problematikën mbi financimin e partive politike janë siguruar së pari përmes raporteve zyrtare të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe të raporteve të posaçme të hartuara nga auditues të licencuar që janë punësuar me kohë të pjesshme nga ana e KQZ . Ndërkohë burime të tjera për njohjen me gjendjen e praktikave të financimit janë shfrytëzuar edhe raportet e organizatave ndërkombëtare ku bëjnë pjesë kryesisht OSBE, Këshilli Evropës dhe Komisioni Evropian BE.**
- **Materiale të tjera janë siguruar nëpërmjet studimit dhe hulumtimit të faqeve të internetit të partive politike dhe çdo burimi tjetër që shfrytëzohet nga ana e tyre për përmbushjen e detyrimit të transparencës ndaj publikut dhe institucioneve shtetërore.**

Kreu I

PARTITE POLITIKE DHE FUNKSIONET E TYRE

1.1. Çfarë është një parti politike?

Partitë politike janë forma të veçanta të organizimit social.

Ato nuk duhet të ngjërrohen me asociacionet, federatat, dhe klubet shoqërore. Një definicion i njohur i partive politike vjen nga Shkencëtari i shkencave politike Antony Downs, i cili shkruan: "Një parti politike është një ekip i burrave që kërkon të kontrollojë aparatet qeverisëse duke fituar zyrën gjatë një pullë të zgjedhjeve të rregullta. Dijetari Italian Giovanni Sartori, i cili ligjëroi për një kohë të gjatë në Universitetin e Kolumbisë në New York dhe është një nga hulumtuesit më të njohur të partive politike, ai e ka definuar një parti si: "cili do grup politik i identifikuar me një emërtim zyrtarë i cili paraqitet gjatë zgjedhjeve,

dhe ka aftësi që nëpërmjet zgjedhjeve të vendos kandidatët për zyrën publike." Edhe nëse këto definicione demonstrojnë disa dallime në të kuptuarit e partive politike, ato të gjitha theksojnë pjesëmarrjen në zgjedhje dhe interesin që të fitojnë zyrat publike dhe mandatet si elemente thelbësore që karakterizojnë partitë politike. Ato duhet pajetër të arrijnë disa kritere të cilat mund të përmbliidhen si në vijim.

Pse ekzistojnë partitë?

Brenda çdo shoqërie ekzistojnë opinione, nevoja, pritje dhe pikëpamje të ndryshme për problemet ditore; gjithashtu ekzistojnë pyetje të "mëdha" mbi organizimin e shoqërisë, normat dhe procedurat. Nuk ekziston diçka e ngjashme me vullnetin e përbashkët të popullatës apo të mira të përbashkëta të para përcaktuara. Ndryshe, në çdo shoqëri ka interesa rivale të cilat shpesh ndeshen shumë fort. Në mënyrë që paqësisht të

Enkeled FIZMANI

ndërmjetësojmë konfliktin, formimi i pikëpamjeve politike duhet të ndodh në një proces të hapur të debatit mes opinionëve të ndryshme. Është i nevojshëm minimumi i bindjes së përbashkët. Ky është mendimi praktik i demokracisë.¹

Bazohet në parimin se secili qytetarë ka të drejtë të përfaqësoj opinionin dhe bindjen e vet në një garë paqësore të mendjeve. Ky supozim i konfliktit të interesave brenda çdo shoqërie, që në parim janë

legjitime, quhet pluralizëm apo "teori konkurrimi" e demokracisë. Sipas kësaj teorie, formimi i opinionit politik në një shoqëri pluraliste arrihet nëpërmes një procesi të hapur të konkurrimit mes interesave heterogjene. Për shkak të llojllojshmërisë së opinionëve dhe konflikteve sociale nuk ka zgjedhje të përsosur për problemet. Vendimet duhet të merren në bazë të pëlqimit dhe aprovimit të shumicës së qytetarëve. Megjithatë, nuk mund të ketë asnjë "tiranë e shumicës" që fyen rregullat demokratike dhe shkel të drejtat e paljetërsueshme të njeriut. Edhe vendimet e shumicës mund të përfshijnë mangësi apo edhe padrejtësi. Prandaj, një mbrojtje e veçantë dhe e garantuar me kushtetutë e pakicave në njërin anë, si dhe pranimi i votimit ose të humbjes në zgjedhje e palës humbëse në anën tjetër, me kusht që ato të jenë (kryesisht) të lira dhe të ndershme - janë elemente konstituive të këtij koncepti të demokracisë.

Brenda kontekstit të konflikteve të interesave të menaxhuara në mënyrë demokratike, partitë politike përfaqësojnë interesa të veçanta. Vetëm atëherë kur të jenë shprehur hapur interesat e kundërta dhe partitë i akordojnë partive të tjera të drejtën për të përfaqësuar interesat e veçanta, dhe kur palët pajtohen me parimet e lojës-politike, për shembull, në qoftë se ata bien dakord kryesisht në kushtetutë demokratike atëherë është e mundur që të zgjidhen konfliktet në një shoqëri dhe të krijohen kompromise politike në një

¹ Max Weber ; www.shtetiweb.org

Financimi i Partive Politike "IDEA-Institute for Democracy and Electoral Assistance"

mënyrë të përshtatshme. Natyrisht, liritë e partive duhet të sigurohen gjatë procesit. Kjo do të thotë se krijimi i partive politike duhet të jetë i lirë nga kufizimet politike.

Megjithatë, mund të ketë disa kufizime sa i përket krijimit të partive të cilat në mënyrë të hapur e kundërshtojnë kushtetutën demokratike të një shteti. Megjithatë, në parim qytetarët duhet të kenë të drejtë të krijojnë një parti, të jenë pjesë e një partie, dhe të shprehin vetën e tyre lirshëm në to.

Liria e partive gjithashtu përfshin nocionin; se askush nuk mund të shtyhet me forcë të aderoj tek një parti e veçantë apo të mbetet në

atë parti përkundër dëshirës së tij- siç ka qenë dhe që mund të jetë ende rasti në disa vende. Afirmimi i shumëllojshmërisë së partive është një konkluzion i njohjes së demokracisë pluraliste. Ky koncept garues i demokracisë qëndron në krahasim me vizionin e homogjenitetit, i cili supozon një unitet të dëshirës së popullit. Filozofi politik Francez Jean-Jacques Rousseau (1712 – 78) e ka krijuar këtë vision që në teori e mohon legjitimitetin e konflikteve dhe e definon demokracinë si një identitet i qeverisë dhe i qytetarëve. Ky koncept nuk e pranon një për një pluralizmin e partive. Ato nuk konsiderohen si legjitime pasi që ato në mënyrë të pashmangshme falsifikojnë “vullnetin e përbashkët” me sjelljen e tyre të veçantë. Devijimet nga e mira e përbashkët e imponuar dhe e detyrueshme nuk tolerohen nga kjo teori. Megjithatë, është e qartë se ky koncept është karakteristikë e shteteve totalitare, ku llojshmëria e partive ndalohej dhe ku “vullneti i përbashkët”, përcaktohet vetëm nga një elitë e vogël sunduese. Rrjedhimisht, shtetet totalitare janë identifikuar me Rousseau. Duhet të theksohet se edhe Rousseau nuk mund të sqaroj se si kjo “logjikë e shëndoshë” do të zbulohet dhe vendoset. Duhet të kemi parasysh se shoqëritë moderne karakterizohen nga shumë llojshmëria e interesave dhe pikëpamjeve.²

² Max Weber; www.shtetiweb.org

Financimi i Partive Politike "IDEA_Institute for Democracy and Electoral Assistance"

1.2. Funksionet e partive politike

Funksionet e opinion-bërjes politike: Ato artikulojnë interesat e përbashkëta sociale. Partitë shprehin prirjet e publikut dhe kërkesat e grupimeve sociale në sistemin politik.

Funksioni i përzgjedhjes: Ato rekrutojnë staf politik dhe ushqejnë gjeneratat e ardhshme të politikanëve. Partitë politike përzgjedhin personat dhe i prezantojnë ata si kandidat për zgjedhje.

Funksioni i integritit: Ato hartojnë programet politike. Partitë integrojnë interesat e ndryshme brenda projektit të përgjithshëm politik dhe i transformojnë në programe politike, për të cilat ato bëjnë fushatë për të marrë pëlqimin dhe mbështetjen e shumicës.

Funksioni i socializimit dhe pjesëmarrjes: Ato promovojnë socializmin politik dhe pjesëmarrjet e qytetarëve. Partitë krijojnë një lidhje midis qytetarëve dhe sistemit politik, ato mundësojnë pjesëmarrjen politike të individëve dhe grupimeve me perspektivën e suksesit.

Funksioni i ushtrimit të pushtetit politik: Ato organizojnë qeverinë. Ato marrin pjesë në zgjedhje në mënyrë që të zënë poste politike dhe ku një pjesë e mirë e autoriteteve qeveritare dalin nga partitë politike.

Funksioni i legjitimitetit. Ato kontribuojnë në legjitimitetin e sistemit politik, në themelimin e lidhjeve mes qytetarëve, grupimeve sociale dhe sistemit politik. Partitë kontribuojnë në ankorimin e rendit për motivet se pse kërkohet dhe është e domosdoshme rregullimi ligjor i financimit të partive politike janë të shumta, ashtu sikundër janë edhe format e rregullimit ligjor. Deri më sot identifikohen qatë të paktën katër kategori arsyesh:

- Parandalimi i abuzivizmit,
- Fuqizimi i një konkurimi politik të drejtë,
- Fuqizimi i votuesve nëpërmjet rregullave ligjore të transparencës dhe ndërshtimit;
- Fuqizimi i partive politike si aktorë efektivë të demokracisë nëpërmjet rritjes së integritetit dhe demokracisë së brendshme.³

1.3. Financimi i Partive Politike dhe Kandidate

a. Argumentet kundër financimit të partive politike dhe fushatave nga buxheti i shtetit:

- Financimi publik rrit diferencën mes elitës politike (lidurve, kandidatëve) me qytetarët e thjeshtë (anëtarët, votuesit, mbështetësit). Për shkak se nuk kanë varësi financiare prej tyre të parët nuk e ndiejnë të nevojshme lidhjen me qytetarët dhe përfshirjen e tyre në proces konsultimi dhe vendimmarrjeje politike.
- Financimi publik ruan *status quo* që mban të lidhur kandidatët dhe partitë politike në pushtet. Për shkak se financimi i partive bëhet për ata që janë në pushtet partitë e reja dhe aktorët e rinj kanë vështirësi të fuqizohen në një mjedis të tillë.
- Nëpërmjet financimit publik, taksapaguesit janë të detyruar të financojnë për ide dhe programe politike me të cilat nuk bien dakort dhe nuk e kanë mundësinë të zgjedhin nëse duhet të financohen apo jo.
- Financimi publik i partive politike dhe kandidatëve merr fondet që mund të shkojnë për shkollat dhe spitalet, ndërkohë që ju jepen partive politike.
- Financimi publik i partive politike dhe kandidatëve vendoset po nga ata që i përfitojnë këto fonde

³ Viktor Gumi-Ekspert Ligjor "Mbeshtetur nga USAID/Shqipëria përmes Assist IMPACT

Enkelet Fizmani

- Partitë politike nëpërmjet financimit publik po bëhen gjithnjë e më shumë organe të shtetit sesa bashkime vullnetare individuale.

b. Argumente pro financimit publik të partive politike dhe kandidatëve:

- Financimi publik i partive politike është kosto natyrale dhe e nevojshme e demokracisë.

- Financimi publik ul influencën e parësë mbi politikën dhe për pasojë ndihmon në uljen e korrupsionit.

- Nëpërmjet financimit publik shteti ka njënjt në dorë të kërkojë prej partive politike ndryshime apo nxitje në jetën politike psh rritjen e përfaqësimit të gruas, minoriteteve, të rinisë, të ndërmarrja reformat e brendshme, etj.

- Financimi publik rrit transparencën sepse financimit duhet t'ia nënshtrojnë rregullave dhe parimeve të përgjithshme të shpenzimeve publike.

- Nëse mungon financimi publik i partive politike dhe partitë financohen vetëm privatisht, pabarazia ekonomike në shoqëri përkthehet në pabarazi politike në qeverisje.

- Partitë politike dhe kandidatët për shkak të rritjes së kostove elektorale kanë nevojë për mbështetje.

- Në shoqëritë në zhvillim dhe me varfëri të lartë qytetarëve nuk mund t'ju kërkohej dhe të pritet që ata të jenë të gatshëm të kontribuojnë për partitë politike.⁴

⁴ Viktor Gumi-Ekspert Ligjor "Mbesh letur nga USAID/Shqipëria përmes Assist IMPACT

Financimi vjetor

Financimi vjetor i partive politike në Shqipëri rregullohet përmes këtyre dispozitave ligjore:

- a) Neni 9, paragrafi 3 në Kushtetutën e Shqipërisë citon se *"Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kudoherë publike"*.
- b) Financimi i aktivitetit vjetor të partive politike rregullohet me ligjin nr. 8580 datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike", të ndryshuar. Dispozitat e tij rregullojnë financimin e partivepolitike nga burimet financiare e materiale, publike e private, të cilat nuk përfshihen në Kodin Zgjedhor. Ligji përcakton kompetencat e kontrollit të financave nga KQZ, rregullat e auditimit dhe përgatitjes së raporteve të rregullta financiare, sanksione për shkeljet dhe mos deklarimin e dhuruesve apo shumave të dhurimit.⁵

c. Limitet mbi financimet private

Ligji "Për Partitë Politike", nga njëra anë, përmes Nenit 21 të tij, i ndalon partitë politike të përfitojnë dhurime financiare e materiale nga qeveri, entitete publike ose private të huaja. Nga ana tjetër, ky Nen lejon dhuratat ose ndihmat që vijnë nga parti apo unione ndërkombëtare partiake, organizata apo fondacione politike, shqiptare dhe të huaja, individë, person fizik apo juridik shqiptar.

⁵ Viktor Gumi-Ekspert Ligjor *Mbeshtetur nga USAID/Shqiperia përmes Assisi IMPACT

Enkeled Fizmani

Ligji citon se dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100,000 Lekë (afërsisht 720 Euro), duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike. Gjithashtu, ndalon përfitimën e fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.

Dhënia e fondeve ndalohet nga një person juridik apo çdo aksionar i tij në rast se ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- a) Ka përfutuar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 000 000 Lekë ;
- b) Ushtron veprimtari në fushën e medias;
- c) Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;
- d) Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.⁶

d. Ndihmat publike

Ligji "Për Partitë Politike" citon se çdo vit në Buxhetin e Shtetit përcaktohet një fond që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

Ndihma financiare e parashikuar në Buxhetin e Shtetit në vitet jozgjedhore, si rregull, nuk mund të jetë më e vogël se ndihma e parashikuar në vitin paraardhës.

Partive parlamentare u mundësohet një udhëtesë për zyrat e tyre qendrore dhe lokale. Kjo mundësi u jepet edhe partive politike, mesatarja e votave të të cilave ka qenë më e madhe

⁶ Viktor Gumi-Ekspert Ugjor *Mbeshtetur nga USAID/Shqipëria përmes Assisi IMPACT

se 1 % në rang kombëtar në tre zgjedhjet e fundit parlamentare. Kur nuk ka ndërtesa të lira përkëtë qëllim, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike.

1.4. Politika dhe paraja

Fondet dhe politika janë të lidhura midis tyre. Në një demokraci pluraliste, në përballimin e detyrave të tyre partisë politike, zyrtarët e tyre kanë nevojë për infrastrukturë e mbështetje financiare, që garantohet nga burime publike e private apo kombinimi i tyre. Sidomos këta fonde bëhen të domosdoshëm në përballimin e fushatave elektorale. Por, ama, ata bëhen dhe burim korrupsioni, duke prekur dhe institucionin e votës së lirë dhe të strukturave që rrjedhin prej saj. Prandaj, kontrolli i praktikave joligjore e abuzive bëhet pjesë e një sistemi rregullator, që në rastin e partive dhe të fushatave elektorale është ende problematik; ai ka nevojë për transparencë, besueshmëri e hapje. Pjesë e këtij sistemi është dhe kodi i sjelljes, që i shërben një klime qytetare e konstruktive në garën politike. Normalisht, një klimë e tillë nuk përfshihet në ligj, por ajo shërben për rritje standardesh, pa tentuar fiksimin apo pandryshueshmërinë e tyre në kod.

Po ashtu, një gjë e tillë i detyron partitë dhe kandidatësh të jenë sa të hapur, po aq të ndjeshëm ndaj kritikës publike. Dhe, më tej, vetë rregullat e financimit të partive dhe të fushatës mundësojnë monitorimin e këtij financimi, të origjinës së fondeve, të ndikimeve potenciale të mëvonshme, etj. Nëpërmjet tyre përcaktohen sasinë e lejuara nga kontribuesit privatë (me emra e adresa); por dhe ato të vetë partive. Pra, kërkohet një kufi dhe një qartësi monetare për kontribuesit, për të shmangur ndikimet korruptive mbi vetë sistemin politik. Krahas këtij limiti kontribuesh (individuale e biznesore), nuk duhet të lejohet anonimatit i tyre (qoftë nga burime të brendshme, qoftë ata të huaja).

Normalisht, kufi duhet të vendoset edhe për sasinë e parave të shpenzuara si parti, apo si individ: për të shmangur abuzimin e parave, teprimin në marketingun televiziv, etj. Pjesë

Enkeled Fizmani

e kontrollit dhe e reagimit duhet të jetë dhe përdorimi i mjeteve shtetërore (makina telefona, fotokopje, etj.), përfshirë dhe autoritetin e zyrës shtetërore që, në fakt, krijojnë pabarazi elektorale midis pozitës dhe opozitës. Po aq i domosdoshëm është deklarimi i pasurisë, i aseteve dhe interesave të kandidatëve para dhe pas zgjedhjeve. Disa elementë të tjerë me peshë, në sistemin rregullator, janë cilësia, nga e cila varet efektiviteti i tij, por edhe thjeshtësia e saktësia e funksionimit të agjencive, që merren me financimin e partive, si brenda partive, ashtu dhe strukturave shtetërore. Mbi të gjitha, pjesë tepër e rëndësishme është vullneti politik dhe angazhimi përkatës, si në përmirësimin e sistemit rregullator dhe legjislativ përkatës, ashtu dhe implementimi efektiv e korrektësia e tij në zbatim. Edhe shoqëria civile dhe media në rolin e auditit social nuk duhet të rrinë indiferente në monitorimin e financimit politik, natyrisht duke respektuar norma të caktuara, sidomos për çështje të karakterit kushtetues (si e drejta e privacisë, liria e shprehjes dhe e mendimit, liria politike).

Shtojmë se për një përdorim korrekt të sistemit rregullator të financimit politik-partiak një rol të rëndësishëm kanë edhe agjencitë përgjegjëse. I tillë është ndonjë departament qeveritar (në Gana, Liberi, Siera Leone, etj.); në disa vende zyra e prokurorit të përgjithshëm; në Gjermani, Itali, Greqi, etj., spikeri i parlamentit. Në vende të tjera funksionon si një zgjidhje ndërmjetëse një zyrë auditimi apo kontrolli shteti (Austri, Spanjë, Izrael), një agjenci specifike e pavarur në trajtën e një komisioni elektorale (në Australi), një zyrtar zgjedhor në Kanada; komisioni zgjedhor federal në SHBA, etj. Në rastin shqiptar, përveç auditit e kontrollit të brendshëm të partive, detyrën për fondet e mbledhura (përdorura), shkeljet, kontrollin dhe investigimin e tyre, e ka KQZ-ja. Pra, në përgjithësi, këto agjenci kanë fuqinë e regjistrimit të partive politike, atë të monitorimit të aktivitetit financiar, mbikëqyrjes së donacioneve dhe shpenzimeve, përgatitjes së raportit publik në kuadër të llogaridhënies dhe luftës kundër korrupsionit.

Po ashtu, ata kanë fuqinë për të investuar parregullsitë apo, në pamundësi ligjore për këtë, për të sugjeruar investigimin ndaj tyre nëpërmjet agjencive më të specializuara. Veç të

tjërash, ata duhet t'u japin përgjigje e zgjidhje ankesave të partive politike e kandidatëve të veçantë ndaj abuzimeve të ndryshme, sidomos të opONENTËVE ELEKTORALË. Madje, sipas rastit, institucione të tilla mund të vendosin sanksione administrative e penale: në mënyrë të drejtpërdrejtë (komisioneri në Kanada) apo nëpërmjet organeve të tjera (p.sh., në Shqipëri, nëpërmjet gjykatë-prokurorisë). Ato, për të qenë efektive, kërkojnë burime financiare të mjaftueshme, por dhe personel të kualifikuar, qëllë për kontrollin e aspekteve financiare e legale të procesit electoral por dhe, në përgjithësi, të gjithë procesit politik-partiak.⁷

1.5. Kontrolli shtetëror i financimit të partive politike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore. Përpara tij, një pjesë të këtyre kompetenca i kishte Kontrolli i Lartë i Shtetit por Neni që përcaktonte këto kompetenca u shfuqizua përmes vendimit nr.33 datë 9.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

Kompetencat e KQZ përcaktohen në Nenin 15/2 të Ligjit nr.8380 datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" – ndryshuar me Ligjin nr.9542 datë 2.2.2006 dhe me Ligjin nr. 10 374 datë 10.2.2011 si vijon:

a) Harton dhe miraton rregullat për raportimin e financimit, për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike, si dhe për formatet e standardizuara për raportimin financiar vjetor ;

b) Miraton formatin e regjistrit të posaçëm të fondeve jopublike të partive politike, si dhe formatin për formën dhe përmbajtjen e deklaratës së dhurimit të fondeve jopublike ;

c) Mban listën e ekspertëve kontabël të licencuar dhe i cakton me short ata për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike ;

⁷ Mbi Financimin e Partive Politike nga Rexhep Mejdani, botuar ne PANORAMA

Enkeled Fizmani

d) Monitoron, mbikëqyr dhe auditon financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre;

e) Vendos sanksione kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji ;

f) Ilarton programe ndërgjegjësuese dhe organizon trajnime për financimin e partive politike dhe të subjekteve të përfshira në këtë proces, sipas dispozitave të këtij ligji ;

g) Përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj;

h) Nxjerr akte nënligjore në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Ligji “Për Partitë Politike” i detyron partitë politike në Shqipëri të mbajnë librat e kontabilitetit të brendshëm dhe të raportojnë mbi asetet që disponojnë, të ardhurat dhe shpenzimet. Partitë duhet të dorëzojnë raportet financiare një herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), së bashku me raportin e auditimit të përgatitur nga kontabilistë të certifikuar sipas përshkrimit përkatës në ligj.

Raportet financiare vjetore përgatiten, nënshkruhen dhe dorëzohen nga personi përgjegjës për financat në partinë politike apo personi i zgjedhur sipas përcaktimit në Statutin e partisë. Në rastet e vitit elektorale, raporti financiar vjetor i partisë duhet të dorëzohet së bashku me raportin financiar të fushatës elektorale. Raporti financiar vjetor, raporti i auditimit dhe raporti i KQZ duhet të publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ jomë vonë se 30 ditë nga data e dorëzimit të tyre pranë KQZ.

Dispozitat ligjore në fuqi nuk mundësojnë rregullime të detajuara nëse regjistrat financiarë duhet të mbahen për një afat kohor të parashikuar.

Partitë politike në Shqipëri nuk i publikojnë vetë informacionet financiare as për publikun e gjerë, as për anëtarët e tyre. I vetmi informacion është ai i mundësuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ.

Në faqet zyrtare të internetit të partive politike në Shqipëri nuk ekziston asnjë informacion i vlershëm lidhur me financimet e partisë. Anëtarët e partive e konsiderojnë të vështirë sigurimin e informacionit mbi fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia e tyre. Partitë politike në Shqipëri kanë një mungesë të theksuar të transparencës së brendshme në lidhje me financat dhe donacionet.

Neni 23/4 i Ligjit "Për Partitë Politike" mundëson në përgjithësi një komizë të mirë për parandalimin e shkeljeve financiare nga ana e partive apo mospërfundimit me rregullat. Sanksionet përmbajnë rregulla adekuatë, por megjithatë duhen mundësuar përcaktime më të qarta për raste specifike me qëllim që të mos krijohen hapësira për boshllëqe në praktikë.

Ligji parashikon sanksione si vijon:

- Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në parti të politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 Lekë.
- Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1,000,000 deri në 2,000,000 Lekë.
- Refuzimi për të bërë transparente burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2,000,000 deri në

Enkeled Fizmani

5,000,000 Lekë.ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

- Shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 Lekë.
- Fondet jopublike të përfituara nga partia politike, kur identiteti i dhuruesit nuk njihet apo nuk është i përcaktuar qartë, kalojnë për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Prurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100,000 Lekë dhe kurtransaksioni nuk është kryer nëpërmjet llogarisë bankare dënohet me gjobë në masën 30 % të shumës së dhuruar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive dhe fushatave zgjedhore.KQZ përzgjedh listën e ekspertëve kontabël të licencuar dhe i cakton me short ata për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike, si dhe mbikëqyr financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike. KQZ vendos sanksione kur konstaton shkelje të ligjit dhe përrekon masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.Ky institucion është gjithashtu përgjegjës për organizimin e programeve ndërgjegjësuese dhe trajnimeve për financimin e partive politike dhe të subjekteve të përfshira në këtë proces, sipas dispozitave të këtij ligji.

1.6. Financimi i fushatave zgjedhore

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0,5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje.Fondi përrekonhet me vendim të Kuvendit

dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit. Ky fond nuk mund të jetë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.

KQZ-ja, përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e radhës, që kanë fituar jo më pak se 0,5 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendorë në shkallë vendi. KQZ-ja përlllogarit shumën që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet e radhës.

Burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë:

- a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore;
- b) të ardhurat e veçë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit;
- c) dhuratat në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna;
- ç) kreditë e marra nga partitë politike sipas ligjit.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj entit tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/duke emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

"Burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime

Enkeled Fizmani

zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

Subjektet zgjedhore mund të marrin fonde, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas.

Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlefëta në sende ose shërbime.

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij, nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme;

a) ka përlituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;

b) ushtron veprimtari në fushën e medias;

c) ka qënë partner me fonde publike në projekte të ndryshme;

ç) ka detyrime monetare ndaj Budgetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.

Ky detyrim nuk zbatohet nëse aksionari i zotëron këto aksione si rezultat i ofertës publike.

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përlituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit,

dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e ndaluesë të Kodit Zgjedhor dhe mban përgjegjësi personale për deklarin të rremë.

Dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme të hapur në një bankë nga subjekti zgjedhor. Përgjegjësi i financës së subjektit zgjedhor, jo më vonë se tre ditë nga fillimi i fushatës zgjedhore, deklaron numrin e llogarisë bankare të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas Kodit Zgjedhor.

Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore.

Subjektet zgjedhore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore.

KQZ-ja publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse. Emri i personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse publikohen bashkë me raportin.

KQZ-ja përzgjedh me konkurrim një listë të ekspertëve kontabël të licencuar në fillim të vitit zgjedhor. Lista duhet të përmbajë të paktën 20 ekspertë, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në 5 vitet e fundit. Procedurat, kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe

Enkeled Fizmani

emërimit të tyre përcaktohen me udhëzim të KQZ-së. Në çdo rast një auditor nuk mund të auditojë të njëjtin subjekt zgjedhur për dy zgjedhje radhazi.⁸

Parimet e financimit të partisë

- Partitë duhet për çdo vit edhe zyrtarisht të llogarisin financat e tyre, sidomos në rastet kur marrin fonde publike;
- Tarifat e anëtarësimit duhet të jenë një pjesë e madhe e të hyrave të partisë. Tarifat e anëtarësimit nuk kanë vetëm efekt financiar, por gjithashtu përmirësojnë identitetin dhe e obligojnë udhëheqësin e partisë që të jenë më transparent ndaj anëtarëve të tyre;⁹

1.7. Mbledhja e fondeve për partitë

Financimi publik i partive nuk duhet të jetë burimi i vetëm e as kryesor i të ardhurave për partitë. Prandaj, partitë duhet të zhvillojnë aftësinë për të krijuar mjete të duhura të të ardhurave. Kjo është një detyrë qendrore për secilin parti dhe për këtë arsye duhet të marr parasysh kur strukturohen dhe ndahen detyrat brenda partisë. Në mënyrë që të mbledhen fondet, është e nevojshme një strategji, dhe kjo duhet të zhvillohet nga arkëtari i partisë. Ai duhet të drejtoj dhe koordinojë të gjitha aktivitetet për të mbledhur fonde; për më shumë, ai duhet të koordinohet me arkëtarët rajonalë dhe lokal të partisë. Në të gjitha nivelet e partisë, duhet të jetë një zyrtar për financa (arkëtar) që është përgjegjës për mbledhjen e fondeve.

⁸ Viktor Gumi-Ekspert Ugjar *Mbeshtetur nga USAID/Shqiperia permes Assist IMPACT

⁹ Uilhelm Hofmajster / Karsten Grabow; Partitë Politike Funkcioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike, Maqedoni 2013; f.....; http://www.kas.de/wf/doc/kas_33531-1522-2-30.pdf?130214155940

Mbledhja e fondëve duhet të bëhet përmes një strategjie.

Masat e më poshtme, mes tjerash janë dëshmuar të suksesshme :

- Lutjet personale për donacionet që janë bërë nga liderët dhe anëtarët apo nga persona të tjerë të afërt me partinë.
- Letrat personale që nxisin donacionet nga anëtarët dhe njerëz të tjerë.
- Mbledhja e komisionit për mjetet e financimit.
- Organizimi i ngjarjeve të veçanta (festave, ahengjeve verore, ngjarjeve tematike) që gjithashtu mund të përdoren për të kërkuar donacione.
- Thirrja e njerëzve për të kërkuar donacione.
- Vizitat shtëpiake të bëra anëtarëve, korporatave dhe personave nga të cilët priten donacione.

Sa i përket tërheqjes së anëtarëve të rinj, kontaktimi personal është dëshmuar të jetë metoda më e mirë për të kërkuar donacione. Megjithatë për këtë është i nevojshëm një regjistër i menaxhuar mirë i anëtarëve dhe simpatizantëve, që i lejon reklamuesit që të synojnë donatorët potencial drejtpërdrejt. Letrat jo-personale masive zakonisht prodhojnë shpenzime pa efekt. Donacionet gjithashtu mund të sigurohen në formë të punës vullnetare duke ndihmuar që të organizohen evenimente dhe ngjarje informuese, të ashtuquajturat “mbledhje votash në rrugë” gjatë fushatave zgjedhore, apo duke siguruar dhoma të takimit për partië. Është veçanërisht e rëndësishme që për donacionet në të holla partia të shpjegoj donatorëve për çfarë qëllimi do të përdoren donacionet. Kjo është një çështje e transparencës dhe në përgjithësi e rrit gatishmërinë për të dhuruar. Partitë duhet që gjithashtu të çmojnë donacionet në mënyrë të përshtatshme, për shembull, me një letër personale falënderuese, dhurata të vogla, të ashtuquajtura “dhurata rasti” të tilla si lapsat, fletoret apo çipe USB me logo të partisë, dhe informata të përgjithshme

Enkeled Fizmani

për partinë. Megjithatë, partitë duhet të jenë të kujdesshme që të mos i harxhojnë burimet duke dhënë dhurata bujare. Të gjitha masat e lidhura me mbledhjen e fondeve duhet të përputhen me rregullat ligjore dhe duhet të respektojnë parimin e transparencës.

Mjetet e të hyrave

- **Tarifa e anëtarësimit është burimi më pak kontrovers i të ardhurave.** Tarifat janë shenjë e një marrëveshjeje në mes të anëtarëve dhe partisë së tyre . Pagesat e anëtarësimit nuk janë vetëm një burim i rëndësishëm financiar por gjithashtu një shprehje e simpatisë për një parti. Fatkeqësisht, anëtarët e varfër shpesh nuk mund të përballojnë pagesën e tarifave. Dhe nëse ka praktika të paligjshme apo keqpërdorim të fondeve të partisë, ka edhe më pak vullnet që të paguhet tarifa. Prandaj, partitë politike duhet të japin llogari për përdorimin e tarifave të anëtarësimit (si dhe të hyrave të tjera) në mënyrë transparente. Edhe në vende të varfra, partitë duhet të mundohen që të mbledhin disa tarifa të vogla nga anëtarët e tyre- por ato duhet të ofrojnë disa shërbime në kthim. Kur nuk ka mënyrë për të mbledhur tarifat në formë të parave, gjithmonë ekziston mundësia e mbledhjes së "tarifave" në formë të shërbimeve për partinë.
- **Kontributet financiare të anëtarëve të parlamentit dhe taksa të ngjashme të zyrtarëve nga partitë;** këta persona kontribuojnë për partinë përtej tarifave të tyre të anëtarësimit, pasi që ata i detyrohen partisë së tyre për mandatet apo pozitat e tyre në administratën publike etj.
- **Të hyrat nga kapitali.** ngjarjet etj; disa parti zotërojnë biznese (për shembull, shtëpi të shtypit për shpërndarjen e dokumentacionit dhe broshurave të partisë etj.) apo kryejnë aktivitetet të tjera nga të cilat gjenerojnë të ardhura. Në parim, ato duhet zyrtarisht të llogaritin të gjitha të ardhurat nga aktivitetet e tilla dhe kapitalin e tyre.

- Donacionet janë burimet më kontroverse publike i financimit të partive. Kjo është sidomos për partitë e mëdha që marrin një pjesë të rëndësishme të ardhurave të tyre përmes donacioneve.¹⁰

Shqetësimi është se donatorët e mëdhenj ekonomik mund të përpiqen të ushtrojnë ndikim politik përgjatë kësaj ruge. Kjo dotë kundërshtonte parimet e barazisë demokratike.

- Kreditë janë një burim i rëndësishëm por problematik i financimit të partive politike. Kredit do të dërgojnë në borxhe, dhe për shumë parti borxhet paraqesin një problem serioz. Nuk është e lehtë të zvogëlohen borxhet me mjete ligjore. Nëse është e mundur, partitë politike duhet të shmangin këtë burim të financimit. Në çdo rast, ata duhet zyrtarisht të flloqarisin detyrimet e tyre ndaj institucioneve kredituese.
- Rikthimi i shpenzimeve për fushatën zgjedhore. Kjo është një praktikë e zakonshme e financimit publik të partive. Rikthimi i shpenzimeve të fushatave zgjedhore është zakonisht i lidhur me rezultatin e zgjedhjeve të një partie.

¹⁰ Wilhelm Hofmayer / Karsten Grabou; Partitë Politike: Funkioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike, Maqedoni 2013: f.....; http://www.kas.de/wf/doc/kas_33531-1522-2-30.pdf?130214155940

1.8. Buxheti i Partise

- Kontributet qeveritare për partitë duhet të respektojnë parimin e mundësive të barabarta, si dhe ndikimin e zgjedhjeve, që është shprehur nga rezultati i saj zgjedhor;
- Vëllimi total i kontributit të qeverisë duhet të rregullohet;
- Në lidhje me kontributin qeveritar për partitë, volumi i donacioneve të qeverisë duhet të merret parasysh;

• Kufiri i zbritycs së taksave për tarifat e anëtarësimit dhe donacionet duhet të caktohet sa më ulët që të jetë e mundur;


• Nga një limit i preferuar i ulët e më tej donacionet e partise duhet të bëhen publike.¹²

Buxheti i Shkollit financoon nëpërmjet një zëri të qinjur "Partitë Politike" në kategori:

- Partitë Politike,
- Shogatat
- Organizatat e Vetranëve me Status.

¹² Opendataat : Geni Muraroli

<http://open.data.al/sq/rajme/rajme/rajme/sq/d/202/Financim-i-Partive-Politike-Shogatare-dhe-Organizatare-te-Vetranëve-me-Status/shtashn8Xfww3LdpuF>



Burimi i të dhënave: Ministria e Financave
Përpunimi dhe komentet: ODA

Në grafikun në vijim jepet totali i financimit për të tre kategoritë së bashku: Mbeshtetje për Partitë Politike, Mbeshtetje për Shoqatat dhe Mbeshtetje për Veteranët me Status si dhe financimi vetëm për Partitë Politike.


Fondet e alokuara për Partitë Politike zënë pjesën më të madhe, mesatarisht 95% të financimit për këto tre forma të organizimit shoqëror.

Enkeled Fizmani

Nga viti 2003 në vitin 2004 ka patur një rritje rreth 4% të financimit për Partitë Politike, ndërsa për vitin 2005 ato kanë vazhduar të jenë në masën 194 milionë lekë.

Në vitin 2006 ka pasur një rënie të lehtë me 2 milionë lekë dhe ky nivel ka vazhduar edhe për tre vite të tjera. Në vitin 2010 fondet për Partitë Politike u rritën me 3.6%, duke shkuar në 199 milionë lekë dhe në vitin 2011 ato janë parashikuar 200 milionë lekë. Ajo që bie në sy nga grafiku është trendi pothuajse linear në financimin e tyre.

Pas vitit 2009, rritje ka pësuar edhe programi “Mbështetje për Shoqatat”, ndërkohë që “Mbështetje për Veteranët me Status” ka qëndruar në nivelin e 3 milionë lekëve.¹³



Burimi i të dhënave: Ministria e Financave
Përpunimi dhe komentet: ODA

¹³ - See more at: <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/202/Financimi-i-Partive-Politike-Shoqatave-dhe-Organizatave-te-Veteraneve-me-Status#sthash.nRXEwv31.dpuf>

Në vitin 2010, financimi nga Buxheti për Mbështetjet e Shoqatave është 2-fishuar krahasuar me një vit më parë dhe në vitin 2011 është planifikuar një rritje e mëtejshme me 20%, duke shkuar në 12 milionë lekë.

Të dhënat për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2011 i përkasin Buxhetit të Konsoliduar fillestar. Të dhënat për vitin 2007 i përkasin Buxhetit Suplementar. Të dhënat për vitet 2008, 2009, 2010 i përkasin Buxhetit të Konsoliduar, pas Aktit Normativ. Të dhënat e Partive Politike për vitin 2003 mungojnë. ODA, ka bërë një vlerësim të tyre nisur nga fakti që Mbështetja e Partive Politike zë mesatarisht 95% të totalit të financimit.¹⁴

KREU II

KONTROLI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PER FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE

2.1. Transparenca e të ardhurave të partive politike

Një nga elementët më të rëndësishëm gjatë fushatës elektorale janë dhe të ardhurat që shpenzojnë partitë politike gjatë kësaj fushate. Në këtë mënyrë, financat e partive politike, janë shndërruar në pikat më të rrehta të fushatës elektorale, e veçanërisht në këtë periudhë prag zgjedhjesh. Shumat e mëdha të parave të shpenzuara gjatë fushatës së partive politike, apo dhe të një kandidati për deputet, janë kthyer në modë për politikën shqiptare. Është e vërtetë që edhe në vendet perëndimore e me një demokraci të zhvilluar shpenzohen shuma të mëdha, por në Shqipëri, ndrysha nga këto vende, këto shuma nuk deklarohen, çka të shtyjnë të mendosh se para jo të pastra qarkullojnë në

¹⁴ <https://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/202/Financimi-i-Partive-Politike-Shoqatave-dhe-Organizatave-te-Veteranëve-me-Status#sthash.n8XEwv3L.dpuf>

Enkeled Fizmani

ambjentet politike. Në këto kushte, transparencat e të ardhurave të partive politike, por dhe të kandidatëve për deputet, është një domosdoshmëri për të patur një klasë politike të pastër dhe të paprekshme nga elementi kriminal.

Problemet e mëdha që po kalon vendi ynë me nivelin e lartë të korrupsionit dhe të trafikëve ilegale mund të gjëjnë zgjidhje, vetëm nëpërmjet një transparence të gjerë të fondeve dhe kapitaleve që partitë politike menaxhojnë gjatë fushatave elektorale. Partitë politike duke qenë transparente me publikun do të jenë të imunituara ndaj infiltrimit të elementit kriminal në rradhët e tyre. Shqipëria e paskomunizmit është shndërruar në një vend ku disniveli ekonomik është mjaft i madh. Një grup i vogël njerëzish po mbledhin rreth tyre shuma të mëdha parash, ndërkohe që pjesa më e madhe e popullsisë ndodhet në varfëri, madje një përqindje e lartë jetojnë në nivelet e varfërisë së skajshme.

Në një kohë kur pasga mcsatare e një shqiptari është jo më shumë se 100 dollarë amerikanë, shpenzimi i shumave të mëdha gjatë fushatës së zgjedhjeve nga elementët kriminal, të cilët posedojnë para me bollëk, do të rrezikonte Shqipërinë dhe shqiptarët të mos integrohej në Bashkimin Europian, sikurse dhe do ta shndërronte në një mbretëri të mafi as dhe organizatave kriminale. Duke u ndodhur në këtë udhëkryq, midis të mirës dhe të keqes, do të ishte e domosdoshme që li nancat e partive politike, të jenë transparente. Kur thuhet transparente, nënkuptohet deklarimin e të gjitha donacioneve dhe shumave të parave që u jepen partive politike nga individë apo biznese të caktuar, pra të jetë transparente pjesa e buxhetit të partive që mbushet nga donacionet, e jo pjesa që i jep buxheti i shtetit këtyre partive, pasi kjo kontrollohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në këtë mënyrë Shqipëria do të lërë pas tranzicionin e gjatë dhe politika shqiptare do të shkëputet një herë e mirë nga elementët kriminalë dhe mafi ozë. Në gjitha kjo do të pasqyrohet në ngritjen e nivelit ekonomik të vendit si dhe në përmirësimin e jetesës së qytetarëve shqiptarë, të cilët e meritojnë të jenë në krah të popujve të tjerë evropianë.¹⁵

¹⁵ Fletora e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reforme Politike, fq.14

Ligji Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" parashikon informimin në lidhje me fondet partiake.

1. "Autoritet publik":

a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;

b) janë shoqëritë tregtare kur:

i) shteti zotëron shumicën e aksioneve;

ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "e" të kësaj pike;

c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

"Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet durazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:

Enkelled Fizmani

- a) ankuesi ka marrë njohim për refuzimin e informacionit;
- b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashirime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:

- a) mospranimin e ankesës kur:
 - i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;
 - ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
 - iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
- b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;
- c) rrezimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
- d) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.

Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit ankuesit i lind e drejta për t'u drejtuar gjykatës.

Kazus për transparencën dhe të drejtën e informimit

Zonja I, është drejtuesja ekzekutive e shoqërisë "JETA", organizatë joqeveritare që ka në fokus të saj ndërgjegjësimin dhe ndalimin e abortit në Shqipëri dhe për këtë gjë kërkon ndryshimet ligjore.

Partitë politike në vend nuk kanë qëndrim të shpallur për këtë çështje dhe për pasojë ju ka lejuar anëtarëve të tyre të gjykojnë personalisht për një çështje të tillë.

Data 31 maj është shpallur datë e zgjedhjeve parlamentare dhe Zonja L, 5 ditë para kësaj date shpërndau 50 000 mijë fletëpjosje ku jepte informacion për OJF-në dhe qëllimet e saj.

Në faqen e parë kishte vendosur fotografinë e saj së bashku me pesë kandidatët e Partisë A në Qarkun e Gjirokastrës. Kjo fotografi ishte bërë në një takim që ajo kishte pasur me të gjithë kandidatët e Qarkut të Gjirokastrës që garonin për partinë A, me pëlqimin dhe dijeninë e tyre të plotë.

Për ta bërë tërheqëse fletëpalesjen ajo në fotografinë e përbashkët kishte vendosur mbishkrimin: "Zgjedhja e duhur".

Këto fletëpalesje ishin shpërndarë kryesisht në Qarkun e Gjirokastrës.

Me përfundimin e fushatës zgjedhore dhe rezultati të zgjedhjeve, partia B paraqet ankesë në KQZ-në se Partia A, duke deklaruar se shpenzimet në kulirin maksimal ligjor të lejuar, duhet t'i shohet edhe financimi i 50 000 mijë fletëpalesjeve me një vlerë minimale 1 euro /copa dmth 50 000 euro.Për këtë shkak duke qënë se me këtë shumë është shkelur detyrimi ligjor, KQZ-ja duhet të ndërshkojë administrativisht sipas ligjit zgjedhor Partinë A.

Enkelet Fizmani

- Kodi Zgjedhor përcakton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive dhe fushatave zgjedhore. KQZ përzgjedh listën e ekspertëve kontabël të licencuar dhe i cakton me short ata për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të partive politike, si dhe mbikëqyr financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike. KQZ vendos sanksione kur konstaton shkelje të ligjit dhe përcakton masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Ky institucion është gjithashtu përgjegjës për organizimin e programeve ndërgjegjësuese dhe trajnimeve për financimin e partive politike dhe të subjekteve të përfshira në këtë proces, sipas dispozitave të këtij ligji.
- Ligji "Për Partitë Politike" i detyron partitë politike në Shqipëri të mbajnë librat e kontabilitetit të brendshëm dhe të raportojnë mbi asetet që disponojnë, të ordhurat dhe shpenzimet. Partitë duhet të dorëzojnë raportet financiare një herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), së bashku me raportin e auditimit të përgatitur nga kontabilistë të certifikuar. Raportet financiare vjetore përgatiten, nënshkruhen dhe dorëzohen nga personi përgjegjës për financat në partinë politike apo personi i zgjedhur sipas përcaktimit në Statutin e partisë. Në rastet e vitit elektorale, raporti financiar vjetor i partisë duhet të dorëzohet së bashku me raportin financiar të fushatës elektorale. Raporti financiar vjetor, raporti i auditimit dhe raporti i KQZ duhet të publikohen në faqen zyrtare të Internetit të KQZ jomë vonë se 30 ditë nga data e dorëzimit të tyre pranë KQZ.
- Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e ndaluese të Kodit Zgjedhor dhe mban përgjegjësi personale për deklarin të reamë.

- Jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, KQZ-ja emëron me short një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore. Subjektet zgjedhore duhet të vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore. KQZ-ja publikon raportet e auditimit për subjektet zgjedhore jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse. Emri i personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse publikohen bashkë me raportin.¹⁶
- KQZ-ja përzgjedh me konkurrim një listë të ekspertëve kontabël të licencuar në fillim të vitit zgjedhor. Lista duhet të përmbajë të paktën 20 ekspertë, të cilët e ushtrojnë këtë profesion në 5 vitet e fundit. Procedurat, kriteret e përzgjedhjes së listës paraprake dhe emërimit të tyre përcaktohen me udhëzim të KQZ-së. Në çdo rast një auditor nuk mund të auditojë të njëjtin subjekt zgjedhor për dy zgjedhje radhazi.

2.2. Sanksionet ndaj partive për shfrytëzimin e pasurive publike

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj entit tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqytës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Burime quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të

¹⁶ Raport mbi financimin në Partitë Politike Shqiptare 2016, fq 8
 Imstututi i Studimeve Politike (www.isp.com.al) – pjesë e database www.politike.al

Enkeled Fizmani

“burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore.

Burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit, dhuratat në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna dhe kreditë e marra nga partitë politike sipas ligjit.

Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti public në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

Ligji Kodi Zgjedhor parashikon se shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 Lekë. Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licencuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1,000,000 deri në 2,000,000 Lekë. Refuzimi për të bërë transparente burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2,000,000 deri në 5,000,000 Lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

Shkelja e afatit të dorëzimit të raportit financiar në kohën e duhur apo paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 Lekë. Fondet jopublike të përfutuara nga partia politike, kur identiteti i dhuruesit nuk njihet apo nuk është i

përcaktuar qartë, kalojnë për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pranimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100,000 Lekë dhe kur transaksioni nuk është kryer nëpërmjet llogarisë bankare dënohet me gjobë në masën 30 % të shumës së dhuruar.¹⁷

2.3. Problematika e Financimit të Partive politike

Modeli shqiptar për financimin e partive politike është ndjekur si shembull marrë nga mijat vende të tjera në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Në vështrim të përmbyshjes së nevojave për zbatimin e drejtë të kushtetutës në kuadër të financimit të partive politike, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me Vendimin e saj Nr. 28/2012 është shprehur se edhe pse në parim mbështetja financiare e shtetit ndaj partive politike ka rëndësi në një shtet të së drejtës, kjo megjithatë nuk nënkupton që ajo nuk ka kufij, ajo nuk mund të tejkalojë një masë që respekton parimin e ndarjes së partive politike nga shteti. Gjykata vlerëson se kjo mbështetje financiare e shtetit mund të kufizohet mbi bazën e kontributit të partive politike, duke e vlerësuar atë në termat e “seriozitetit të përpjekjeve të partive konkurruese” ose të “*seriozitetit të qëllimeve elektorale të partive*” që shpreh një shkallë të përfaqësimit të tyre. Qëllimi i financimit nuk mund të jetë kufizimi i konkurrimit të lirë por ai duhet të sigurojë seriozitetin e kësaj gare. Ai nuk është një instrument për integrimin e partive politike, por thjesht një përcaktues i faktit nëse programet zgjedhore kanë pasur qëllime serioze, nëse ato janë orientuar ekskluzivisht drejt suksesit të zgjedhjeve dhe jo ndaj qëllimeve të tjera.

Në kontekst të vendimit të nësipërm Gjykata Kushtetuese ka paraparë të nevojshme të sqarojë një ekuilibër të brishtë midis nevojës për të financuar partitë politike nga njëra anë dhe seriozitetit të veprimtarisë së tyre nga ana tjetër me qëllim që ky financim të vlejë si një e mirë publike në shërbim të qytetarëve. Financimi i partive politike në aspektin teorik mundëson parandalimin i abuzivizmit në veprimtaritë politike me fonde të fshehta,

¹⁷ Raport mbi financimin e Partive Politike Shqiptare 2016, fq 10
Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) – pjesë e databasë www.politike.al

Enkeled Fizmani

garanton një konkurrim politik të drejtë dhe të ndershëm, konsolidon besimin e votuesve për rregulla ligjore të transparencës dhe ndësbkimit ndaj rasteve abuzive, si dhe afirmon partitë politike si faktor të rëndësishëm të demokracisë nëpërmjet forcimit të integritetit dhe praktikave të ndershme të organizimit të brendshëm.

Sipas teorisë moderne të lidershit dhe organizimit të subjekteve politike financimi i partive politike përbën një kosto të nevojshme për forcimin dhe konsolidimin e demokracisë. Kjo formë e financimit më transparencë dhe rregulla të qarta ul ndikimin dhe influencën e kapitalit dhe shkëmbimit të paligjshëm të parasë mbi politikën dhe për pasojë redukton ndjeshëm fenomenet e korrupsionit brenda radhëve të partive politike.

Nëpërmjet financimit të partive politike shteti shfrytëzon këtë rol për të kërkuar subjekteve politike ndryshime apo reforma në jetën politike dhe fushave të tjera prioritare. Financimi publik në këtë rast rrit transparencën, sepse ai i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të përgjithshme të shpenzimeve publike.

Në rastet kur mungon financimi publik i partive politike dhe këto të fundit vetë financohen privatisht, pabarazia ekonomike në shoqëri reflektohet edhe në pabarazi politike në qeverisje dhe në garat elektorale. Partitë politike dhe kandidatët për shkak të rritjes së kostove gjate fushatave e kanë nevojë jetike mbështetjen financiare. Në shoqëritë në zhvillim dhe me nivele të larta varfërie, qytetarët nuk posedojnë mundësi për të kontribuar njaftueshëm për mbështetjen financiare të partive politike, ndaj ky rol domosdoshmërisht që bie mbi shtetin si një rregullator i madh.¹⁸

Fenomeni pabarazi nëpërmjet partive politike shfaqet sidomos kur partitë më të mëdha, në disa raste, janë raportuar se përdorin automjetet publike dhe ndërtesat zyrtare për qëllime fushate, e cila është e ndaluar me ligj. Disa herë ceremonitë e qeverisë u pasua nga reklamat e fushatës së partisë në pushtet, duke e detyruar disa pjesëmarrjen e nëpunësve civilë. Kjo ka krijuar konfuzion në përcaktimin e linjave të qarta midis institucioneve

¹⁸ Raport mbi financimin në Partitë Politike Shqiptare 2016, fq 12
Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) – pjesë e database www.politike.al

shtetërore dhe interesave partiake, duke sfiduar edhe standardet ndërkombëtare, sipas raporteve të OSBE-së:¹⁹

Sa i përket partive të reja ose kandidatëve të pavarur që marrin pjesë për herë të parë në një fushatë zgjedhore, raportet në përfundim të zgjedhjeve kanë evidentuar një mungesë totale të ndihmës financiare nga buxheti i shtetit.²⁰

Sipas auditimeve të zgjedhjeve të dorëzuar në KQZ, janë vërejtur nivele të larta të shpenzimeve të papaguara sidomos të reklamave politike në transmetimin televiziv.²¹

Rezultatet e tjera të treguara nga raportet e auditimit pasqyrojnë shqetësimin se shpenzimet kanë tejkaluar të ardhurat totale, ndërsa mjettet janë të pamjaftueshme ndërkohë që shpenzimet kanë qenë të pajustificuara.²²

Transparenca e financimit të partive politike është një çështje që edhe pse e rregulluar me ligj, hetime të dobëta administrative janë ndërmarrë deri më tani ku autoritetet publike janë bazuar vetëm në të dhënat e dorëzuara nga palët ose nga vetë-deklarimet e tyre. Në këtë aspekt, sanksionet e parashikuara në ligj janë të parëndësishme për të zbatuar transparencën plotë dhe vullneti për t'i implementuar ato nga KQZ-ja mungojnë për shkak të ndikimit politik.

¹⁹ OSCE/ODIHR 2013 Election Observation Mission Final Report, Albania, page 2: <http://www.osce.org/odihr/elections/106967?download=true>

²⁰ OSCE/OSCE 1990 Copenhagen Document, paragraph 5.4: <http://www.osce.org/sih/elections/14304?download=true>

²¹ Audit Reports PS dhe PR: http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=1682:1-Auditimet-e-auditimit-te-subjekteve&catid=131:3-A-financimi-i-subjekteve&Itemid=123&lang=en

²² Audit Report LSI: http://www.cec.org.al/images/stories/zgjedhje-per-kuvend/2013/rap_audit_LSI.pdf

Enkeled Fizmani

Partitë politike konsiderohen transparente sipas ligjit, me detyrimin për të publikuar tri raporte, në mënyrë eksplicite, raportin vjetor financiar, raportin e auditimit të ekspertëve të certifikuar kontabël të caktuar nga KQZ-ja dhe raportin e auditimit të fushatës zgjedhore. Detyrimi i tyre i dorëzimit të raporteve të KQZ-së, është konsideruar në vijimësi i parcalizueshëm nga shumica e partive politike dhe një numër i vogël i tyre kanë përmbushur dispozitat ligjore për të gjitha raportimet.

Raportet e auditimit për periudhën zgjedhore, janë realizuar përgjithësisht nëpërmjet procedurave të formale nga pothuajse të gjitha partitë dhe madje edhe nga kandidatët të pavarur. Megjithatë, pavarësisht nga detyrimet e tyre në dorëzimin e raporteve në KQZ, konstatohet se komiza ligjore që përcakton këtë detyrim nuk parashikon afate specifike përdorëzimin e tyre nga partitë politike.

KQZ-ja është përgjegjëse për publikimin e raporteve brenda 30 ditëve nga paraqitja e tyre dhe zbatimi i këtij detyrimi realizohet vetëm nëpërmjet publikimit të tyre në faqen e internetit zyrtar të këtij institucioni. Ndërkohë, partitë politike nuk bëjnë publike raportet e tyre financiare me anë të mjeteve të tyre të informacionit dhe ka mungesë të rregullave në lidhje me mënyrën dhe afatet e përmbushjes së kësaj transparence. Kjo çështje është ngritur edhe në raporte ndërkombëtare, ku shqetësimi për transparencën e partive politike ka qenë lidhur me neglizhencën e tyre në procesin e vetë-informimit publik.²³

Në përgjithësi website i KQZ-së është lehtësisht i aksesueshëm nga publiku në lidhje me pasqyrat financiare të deklaruara nga partitë politike. Megjithatë mbeten shqetësim në raporte financiare të cilat për shkak të vonësive apo procedura të tjera burokratike nuk janë bërë kurrë publike në faqen e internetit të KQZ-së ose nëpërmjet buletineve (*hard copy*). Njëkëtë aspekt nuk janë evidentuar përpjekje zyrtare të KQZ për të marrë masa për

²³ Transparency International Albania, CRINIS report, "Buying Influence: Money and Political Parties in Albania"; page 19: http://www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

publikimin etyre te mëvonshëm ose për masa me karakter administrativ ndaj subjekteve politike te veçanta.

Praktika në lidhje me donacionet dhe fondet mbështetëse që vijnë nga individë privat aposubjekte te tjera është përmirësuar për shkak të përpjekjeve të partive politike që të pasqyrojnë plotësisht gjeneralitetet dhe shumën e donacioneve në llogarinë bankare zyrtare të tyre. Gjithsesi, problem mbetet autenticiteti i dyshimtë i deklaratave dhe fondeve qefshëhin donatorët e vërtetë te cilët shmangin te përballen me hetime të mëtejshme nga auditimi. Ky shqetësim përfshin edhe donacione në natyrë të cilat nuk janë të jund pasqyruar në pasqyrat financiare të partive politike.

Edhe pse raportet financiare përfshijnë informacione shtesë të detajuara mbi donacionet, të tilla si, emrin e donatorëve, data dhe shumën e çdo dhurimi, kopje të faturave për çdo shpenzim, datën dhe shumën e shpenzimeve dhe emrin dhe numrin e regjistrimit të çdo shitiësi zyrtar, në praktikë parregullsitë nuk janë raportuar kurrë për tu shoqëruar me tej me sanksione.²⁴

Edhe pse KQZ është mbikëqyrëse, duke vënë sanksione dhe duke bërë publike të gjitha raportet të subjekteve politike në lidhje me veprimtarinë e tyre brenda 30 ditëve nga paraqitja, ligji nuk parashikon ndonjë afat për dorëzimin e deklaratave. Ky heshllëk ka krijuar konfuzion në lidhje me procedurat konkrete ligjore të trajtimit të rasteve të vonësive dhe sanksioneve ndaj partive politike.

Megjithëse Gjykata Kushtetuese vendosi të përjashtojë Kontrollin e Lartë të Shtetit nga kontrolli i aktiviteteve financiare të partive politike, duke ja lenë këtë kompetencë KQZ-

²⁴ Transparency International Albania, 2013 CRINIS report, "Buying Influence: Money and Political Parties in Albania"; pages 17, 21:
http://www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

Enkeled Fizmani

së, kjo e fundit nuk ka treguar kapacitet e plotë për të siguruar rregullsinë e raporteve financiare dhe kontrollin e tyre edhe në mënyrë proaktive. Ky pasivitet është nënkuptuar edhe për shkak të përbërjes së KQZ-së me përfaqësues të forcave kryesore politike, të cilët favorizojnë në qëndrimet e tyre subjektet politike që përfaqësojnë.

Komisioni Evropian ka shprehur shqetësime në lidhje me financimin e partive politike, duke sugjeruar se KQZ-ja ka nevojë për të nisur inspektime të konsiderueshme, duke shkuar përtej një qasjeje thjesht formal për të kontrolluar deklaratat e partive politike, dhe për të vendosur përgjegjësitë brenda të qarta për mbikëqyrjen e financave të partive politike.²³

²³ European Commission, 2014 Progress Report, Albania, page 44.
http://ec.europa.eu/euip/arrangement/pdf/kev_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf

PËRFUNDIME

Përpyekje të vazhdueshme duhet të ndërmerren në pikëpamjen ligjore dhe lidhur me rregullat e tjera, të cilat janë të domosdoshme për të garantuar barazi financiare dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet partive politike dhe kandidatëve të tjera të pavarura. Aktualisht rregullat e garimit politik shprehin një pabarazi të theksuar që vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe rendin juridik në tërësi.

- Ligji Për Partitë Politike duhet të amendohet me dispozita shtesë të detyrueshme për aktivitetet e partive politike, që kanë të bëjnë me vetë-publikimin e pasqyrave financiare, informacioneve në lidhje me anëtarët e tyre, nivelin e kuotizacioneve që derdhen, bilanci periodike, të ardhurat dhe shpenzimet si dhe donatorët e fushatave dhe ata që ofrohen gjatë viteve jo zgjedhore.
- Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe organet e tjera ligj-zbatuese në këtë fushë, duhet të jetë më efektive në hetime gjithëpërfshirëse të koordinuara në lidhje me rastet e financimit të dyshimtë të partive politike, duke zbuluar burimin e të ardhurave.
- Rastet e denoncimeve publike të blerjes së votave, kërcënimeve të tjera apo sulme fizike qëndrohin në jetën politike dhe abuzimet me përdorimin e rezervave shtetërore ose publike gjatë fushatave, duhen të jenë në fokusin e organeve ligj-zbatuese për t'i parandaluar në kohë dhe për të ndëshkuar personat përgjegjës me ose pa imunitet.
- Dispozitat ligjore në fuqi lidhur me organizimin dhe funksionimin e partive politike nuk mundësojnë rregullime të detajuara nëse regjistrat financiarë duhet të mbahen për një afat kohor të parashikuar ose duhet të asgjësohen menjëherë. Mos parashikimi i kësaj norme bën të mundur që subjektet politike në rastet e financimeve të dyshimta

Enkeled Fizmani

ta kanë të lehtë t'i shpëtojnë hetimeve të mëvonshme që mund të zhvillohen për raste të tilla.

- **Partitë politike në Shqipëri nuk i publikojnë vetë deklarimet financiare për publikum e gjerë, si dhe për anëtarët e tyre. I vetmi informacion është ai i mundësuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ. Mungesa e transparencës në këtë aspekt është flagrante dhe nuk mundëson një akses publik të qytetarëve mbi partitë politike të cilat nesër mund të marrin në dorë fatet e vendit.**
- **Në faqet zyrtare të internetit të partive politike në Shqipëri nuk ekziston asnjë informacion i vlefshëm lidhur me financimet e partisë, donatorët, kuotizacionet financiare etj. Ka raste si LSI që ka shënuar rritje në publikimin e disa të dhënave financiare (2016), por edhe ato dominohen nga të dhëna formale dhe kryesisht sponsorizime e nishta vullnetare, jo tipike për partitë politike. Në të gjitha partitë anëtarët e konsiderojnë të vështirë sigurimin e informacionit mbi fondet e përfutuara dhe të shpenzuara nga partia e tyre.**
- **Me ligjin mbi të drejtën e informimit, transparencja publike është bërë kriter vlerësimi dhe standard baze për çdo institucion publik, partitë politike si organizata që kryejnë aktivitet kushtetues dhe kanë të përfshirë funksionarë publikë. Vetëm partitë janë gjenerues dhe monitorues të këtij ligji, por në paradoks me sa më lart, ato nuk kanë përmbushur asnjë lloj standardi në këtë aspekt. Partitë vijojnë të jenë të mbyllura për publikun dhe janë hermetike për transparencën dhe llogaridhënien publike.**
- **Legjislacioni shqiptar mbi partitë politike është i paplotë dhe konfuz. Nga monitorimi i kryer nga ISP vetëm 12 nga 126 partitë politike të regjistruara në gjykatë kanë raportuar periodikisht ndryshimet që kërkohen nga ligji. Pjesa tjetër e partive e ka injoruar detyrimin ligjor, disa parti politike figurojnë ende aktive me drejtues të cilët as nuk jetojnë më. Fiktiviteti i partive politike pranohet edhe nga**

KQZ, organ i cili në raportin vjetor 2015 theksoi se nga 118 parti politike të cilat duhet të auditohehin, 71 parti politike nuk u arrit të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

- Referuar standardit minimal të informimit publik, qoftë edhe për aspektin financiar, pjesa më e madhe e këtyre partive nuk kanë faqe interneti, nuk kanë media dhe as burime të tjera publike informimi mbi programin, strukturat, aktivitetin dhe të dhënat e tyre financiare. Partitë kryesore parlamentare: PS, PD, LSI, PDIU kanë faqe interneti, pjesërisht të përditësuar. Partitë e tjera në parlament PDK, PBDNJ, eij, kanë faqe in-aktive interneti, kurse partitë e mbedura, LZHK, PR, PAA, eij, nuk kanë adrese efektive në internet.

- Partitë Politike në shumicën e rasteve janë evidencuar se depozitofund me vonese ose nuk depozitofund asnjëherë pasqyrat financiare në KQZ. Ligji nuk parashtikon një afat për depozitim e pasqyrave financiare të vite-deklarimit nga ana e partive politike dhe një hoshëk i cille shfrytëzohet me abuzivizem nga shume subjekte politike. Në keto raste nuk janë evidencuar sanksione apo masa të tjera administrative ne agatkin te tyre. KQZ ka një rol te konsiderueshem për auditimin e partive politike por kapacitetet e saj janë te pamjaftueshme dhe një mision i cille mbikëqyrës është i pa realizueshem.

Enkeled Fizmani

BIBLOGRAFIA

1. *OSCE/ODIHR 2013 Election Observation Mission Final Report, Albania, page*
2. *OSCE/OSCE 1990 Copenhagen Document, paragraph 5.4:*
3. *Audit Reports PS dhe PR.*
4. *Audit Report LSI:*
5. *Transparency International Albania, CRINIS report, "Buying Influence: Money and Political Parties in Albania"; page 19:*
6. *Transparency International Albania, 2013 CRINIS report, "Buying Influence: Money and Political Parties in Albania"; pages 17, 21:*
7. *European Commission, 2014 Progress Report, Albania, page 44:*
8. *Ligji nr. 119/2014 " Per te Drejten e Informimit "*
9. *Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike*

10. **Dr. Wilhelm Hofmeister** është drejtor i projektit rajonal " Dialogu Politik me Azinë " i Konrad Adenauer Stiftung (KAS), i vendosur në Singapor. Ai ka qenë përfaqësues i KAS-it në Kili, zëvendës drejtor i departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në selinë e saj, dhe nga viti 1999 deri më 2009, ai ishte drejtor i Qendër së Hulumtimeve KAS në Rio de Janeiro, Brazil.

Kontakt: Wilhelm.Hofmeister@kas.de.

Dr. Habil. Karsten Grabow është koordinator për studime politike dhe hulumtime të partive në ekipin e politikave të brendshme në KAS në Berlin. Deri në fund të vitit 2010 ai ishte hulumtues i lartë në departamentin për Bashkëpunim Evropian dhe Ndërkombëtar (BEN) dhe përgjegjës për bashkëpunim ndërkombëtar partiak të KAS-it.

Kontakt: Karsten.Grabow@kas.de

Site interneti:

www.Wikipedia.it/etica

www.shteri.ueb

www.idea-institutefordemocrasyandelectoralAssitence

www.osce.org/odihr/elections/106963?download=true

www.ecc.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=368%3Araportet-e-auditimit-te-subjekteve&catid=131%3Afinancimi-i-subjekteve&Itemid=323&lang=sq

www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

www.transparency.org/files/content/feature/2013_CRINIS_Albania_EN.pdf

ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf

Faleminderit!